

VENDIM
Nr.418, datë 8.6.2011

PËR PROCEDURËN E HEQJES SË LICENCËS SË NDËRMJETËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” dhe të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve i heq licencën çdo subjekti, që ushtron veprimtarinë si ndërmjetës, në rastet e mëposhtme:

- a) Me kërkesën e tij;
- b) Në rast se humbet apo i kufizohet zotësia për të vepruar;
- c) Kur dënohet me vendim të formës së prerë për një vepër penale, të kryer me dashje;
- ç) Kur vërtetohet shkelja e dispozitave urdhëruese dhe ndaluese të ligjit nr.10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”;
- d) Për shkelje të rënda të normave të Kodit të Etikës;
- dh) Në çdo rast tjetër, kur parashikohet shprehimisht në ligj.

2. Procedura e heqjes së licencës fillon brenda 6 (gjashtë) muajve, por jo më vonë se 3 (tre) vjet nga kryerja e shkeljes. Kjo procedurë fillon me kërkesë të subjekteve të interesuara ose kryesisht nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve. Kur procedimi fillon me kërkesë të subjekteve të interesuara, kërkesa paraqitet pranë sekretarit të Komisionit dhe duhet të plotësojë këto kushte:

- a) Të hartohet me shkrim;
- b) Të identifikojë ndërmjetësin, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen;
- c) Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje, dhe rrethanat e kryerjes së tij;
- d) Të shoqërohet me akte të tjera të nevojshme që provojnë kryerjen e shkeljes.

3. Ndërmjetësi, ndaj të cilit ka filluar procedimi, ka të drejtë:

- a) të informohet në mënyrë të qartë dhe të hollësishme për shkeljet që pretendohen dhe faktet rreth tyre;
- b) të formulojë pretendime dhe kërkesa;
- c) të njihet me dokumentet e procedimit dhe të depozitojë prova të mjaftueshme;
- ç) të ketë asistencën e një avokati ose të një kolegu gjatë procedimit dhe të dëgjohet në prani të tij;
- d) të kërkojë thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe të paraqesë dokumente të tjera në mbrojtje të tij, jo më vonë se 2 (dy) javë nga fillimi i procedimit.

4. Komisioni, pas shqyrtimit të fakteve, rrethanave, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët gjatë procedimit, në rast se çmon se vërtetohet një prej rasteve të heqjes së licencës, vendos heqjen e saj. Për zhvillimin e mbledhjes zbatohen rregullat e parashikuara në vendimin nr.414, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizmit e të funksionimit të Komisionit të Licencimit të Ndërmjetësve”.

5. Vendimi i Komisionit për heqjen e licencës përmban të dhëna për:

- a) organin që ka marrë vendimin;
- b) identifikimin e ndërmjetësit, të cilit i hiqet licenca, dhe të dhënat e licencës;
- c) shkeljen faktike;
- ç) bazën ligjore;
- d) rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë procedimit, dhe përfundimet e nxjerra nga Komisioni;
- dh) provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi;
- e) të drejtën për të bërë ankim, afatin për paraqitjen e tij dhe organin përgjegjës për zgjidhjen

e tij.

6. Kundër vendimit të Komisionit, kërkuesit mund të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë. Kundër vendimit të Ministrit të Drejtësisë mund të bëhet ankim në gjykatë. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankimeve bëhen sipas rregullave dhe afateve të parashikuara në ligj për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

7. Pas heqjes së licencës së ushtrimit të profesionit, Komisioni i paraqet strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e Regjistrit të Ndërmjetësve, vendimin për heqjen e licencës me qëllim bërjen e shënimit përkatës në regjistër, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, i cili mbahet nga Qendra Kombëtare e Licencimit.

8. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha